



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 465/1 prot

Elbasan, më 17.02.2025

VENDIM
Nr 6, datë 17.02.2025

Për

trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, për këtë procedurë, është shprehur me vendimin nr 50 datë 28.10.2024 "Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve "Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit" dhe ngritjen e Komisionit 'Ad Hoc'". VBA nr 60 datë 31.12.2024 "Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve "Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit", të ndryshuar, Relacionit date 21.01.2025 "Për trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit", paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit.

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë bursë financiare 37 studentë të vitit të parë me rezultate të paraqitura nga QSHA, pas konfirmimit të statusit të tyre, ndërkohë 4 prej tyre të zbriten nga lista e përfitimit për kriterë të tjera në VBA e mëparshme, sipas listës bashkëlidhur



- 2- Përfitojnë bursë financiare 140 studentë me kritere të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, nga të cilët 139 studentë sipas konfirmimeve pas vendimmarrjeve të mëparshme, ndërsa 1 student është rikonfirmuar nga institucionet, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 194 studentë me kritere të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, ndërsa 1 student është miratuar në vendimmarrjet e mëparshme sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 49 studentë me kritere të tjera dhe 1 student me rezultate nga QSHA.
- 5- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin e tyre apo të mosplotësimit të kritereve të studentëve sipas listës në pikën 1, 2 dhe 3, të mos zbatohet vendimmarrja e përfitimit, ndërsa ndryshimet në rastet e përfitimit të listës së pikës 4 të paraqiten për vendimmarrje në BA.
- 6- Të evidentohen nga komisioni rastet e studentëve me status të pandryshuar; jetimë, i verbër, tetraplegjikë, paraplegjikë, fëmijë i policit të vrarë, romë egjiptian, të cilët kanë studiuar në ciklin e parë në UE dhe kanë përfituar bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, por nuk kanë paraqitur kërkesë deri në periudhën që shqyrtohet, si dhe rastet e paidentuara të studentëve me rezultate (mesatare 9-10-të) dhe të relatohen në Bordin e Administrimit për përfitim bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit
- 7- Vendimmarrja të zbatohet pas konfirmimit të statusit të studentëve.
- 8- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi

